



BULETINI

Prill 2011

Numër 4/2011

Përmbajtja

1. Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)

3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

4. Aktivitetet tjera

ZHVILLIM
PROFESIONAL
GJYQËSOR

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.
"Muharrem Fejza" pa.nr.
Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069
+381 (0) 38 512 081 +381 (0) 38
512 095 www.kjijudicial.org
info@kjijudicial.org

Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

A 7– Civile drejta Evropiane ne praktikë: Hyrje dhe Përqendrim në të drejtën civile IGJK - Twinning



Nga 04 deri më 08 prill 2011, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit për Reformim të Sistemit të Arsimimit Ligjor në Kosovë, mbajti një trajnim pesë ditor me temë “E drejta e Unionit Evropian në praktikë-Hyrje dhe përqendrim në të drejtën civile”.

Në këtë kurs trajnimi u trajtuan çështjet lidhur me të drejtën e Unionit Evropian, historikun dhe strukturën organizative të Unionit Evropian, lidhjen në mes të së drejtës së Unionit Evropian, KEDNJ dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se pjesëmarrësit pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje të:

- interpretojnë nocionin “Unioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe Këshilli Evropian”.
- shpjegojnë rolin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg.
- shpjegojnë rolin dhe funksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.
- bëjnë dallimet në mes GJED në Luxemburg dhe GJEDNJ në Strasburg.
- interpretojnë burimet ligjore të Bashkimit Evropian.
- interpretojnë ndikimet e rregulloreve dhe direktivave Evropiane në ligjet vendore.
- demonstrojnë dhe interpretojnë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmis civile dhe gjyqtarët për kundërvajtje nga të gjitha regionet e Kosovës.

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësve u shpërndanë çertifikata.

Tryezë e diskutimeve: penale Korrupsioni



Më 14 prill 2011, IGJK ka organizuar një trajnim nga lëmia penale, me temë “Korrupsioni”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte diskutimi i disa veprave penale të korrupsionit, si: shkelja e detyrës zyrtare nga ana e personave përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër.

pjesëmarrësit të janë gjendjeje që të:

- Dallojnë fushat ku paraqitet korrupsioni;
 - Identifikojnë format dhe mënyrat e kryerjes së korrupsionit;
 - Aplikojnë format bashkëkohore të zbulimit të korrupsionit;
 - Identifikojnë format dhe mënyrat se si mund të parandalohet korrupsioni;
 - Thellojnë njohuritë lidhur me institucionet që merren me luftimin e korrupsionit;
- Gjatë këtij sesi trajnues u diskutuan çështjet që kanë të bëjnë me situatat kur persona, qoftë zyrtarë publik, qoftë qytetarë kryejnë një ose disa veprime të ndaluara, të cilat për nga motivet dhe qëllimet përbëjnë elemente të veprës penale.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua edhe për identifikimin e veprave penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin meqë për kualifikimi juridik të tyre në praktikën gjyqësore ka paqartësi. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnim për Trajnues: “E drejta Civile e Bashkimit Evropian”

Nga 18 deri më 20 prill 2011, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështetë reformimin e sistemit për arsimim ligjor, organizoi seminarin treditor të specializuar për trajnuesit e tij me temë “E Drejta Civile e Bashkimit Evropian”.

Ky seminar u përqendrua në; hartimin e manualeve gjyqësore për të Drejtën e BE-së të lidhur me praktikën gjyqësore të Kosovës.

Gjatë këtij seminari pjesëmarrësit punuan në grupe për hartimin e draft-manualeve gjyqësore në tema të ndara nën mbikëqyrjen e ekspertëve ndërkombëtar nga lëmia e të drejtës së BE-së.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se pjesëmarrësit pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje të:

- Hartojnë dhe dizajnojnë një Manual Gjyqësor për të Drejtën e BE-së lidhur me praktikën gjyqësore në Kosovë.
- Përpunojnë dhe strukturojnë qartë përmbajtjen e një Manualit Gjyqësor për të drejtën e BE-së.

Përfitues të këtij trajnimi ishin trajnuesit e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Tryezë pune: Penale Dëshmitarët në procedurën penale



Më 21 prill 2011, IGJK ka realizuar sesionin trajnues nga lëmia penale, me temë Dëshmitarët në Procedurën Penale.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte analizimi i çështjeve që kanë të bëjnë me dëshmitarët në procedurën penale për të cilin besohet se mund të ofrojnë informata të rëndësishme për procedurën penale, dhe atë lidhur me: kryerësin e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, të dëmtuarin etj, duke kontribuar në zbardhjen e drejtë të çështjes.

Objektivat e këtij trajnimi ishin që pjesëmarrësit

pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje që të:

- bëjnë sqarimet e duhura lidhur me dëshmitarët e liruar në procedurën penale;
- vlerësojnë efektet e dëshmisë së dëshmitarëve në procedurën penale dhe të bëhet dallimi i tyre;
- shpjegojnë papranueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarëve, si provë në procedurën penale;
- dallojnë rastet se kur një dëshmitar shpallet dëshmitarë i mbrojtur dhe dëshmitar bashkëpunues;

Ky sesioni trajnues u fokusua në trajtimin e çështjet problematike që shfaqen në praktikë nga këndvështrimi profesional me qëllim të unifikimit të zbatimit të dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë sferë.

Me këtë rast përmes shembujve praktik të improvizuar u bë një diskutim interaktiv rreth çështjes së dëshmitarëve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë, të të gjitha niveleve nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Tryezë pune: Penale Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit



Më 26 prill 2011, IGJK ka organizuar një trajnim me temën e lartpërmendur.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e efikasitetit dhe efektshmërisë me rastin e shqiptimit dhe aplikimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Gjatë kësaj tryeze u analizuan çështjet që kanë të

bëjnë me masat të cilat urdhërohen nga prokurori publik dhe nga gjyqtari i procedurës paraprake, çështjet procedurale që ndërlidhen me raportin e prokurorit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, kompetencat e tyre lidhur me aplikimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Ndër objektivat kryesore të këtij trajnimi ishin që pas pjesëmarrësit të janë gjendje të:

- vlerësojnë sa më drejt qëllimin e këtyre masave, me ndihmën e të cilave bëhet mbledhja e dëshmive dhe fakteve;
 - dallojnë masat të cilat urdhërohen nga prokurori nga ato që lëshohen nga gjyqtari i procedurës paraprake; identifikojnë provat të cilat merren pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të prokurorit dhe trajtimin e tyre;
- Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe prokuror nga të gjitha regjionet e Kosovës të të gjitha niveleve.

Trajnim për Trajnues: “E drejta Civile e Bashkimit Evropian - BE-së”

Nga 28 deri më 30 mars 2011, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit i cili mbështetë reformimin e sistemit për arsimim ligjor, organizoi seminarin treditor të specializuar për trajnuesit e tij me temë “E Drejta Civile e Bashkimit Evropian dhe instrumentet relevante ligjore të saj për mbrojtjen e konsumatorit”.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se pjesëmarrësit pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje:

- Të shpjegojnë rolin e legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit.
- Të njohin përmbajtjen e Rregullores së Këshillit Evropian (EC-Brukseli I.) Nr. 44/2001 e 22 dhjetorit 2000 mbi juridiksionin dhe njohjen e përbarimit të aktgjykimeve në çështjet civile dhe ekonomike (Brukseli I).
- Të njohin përmbajtjen e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC),

Nr. 805/2004 e 21 prillit 2004 mbi përbarimin e kërkesëpadive të

pakontestueshme në proceset në mes të shteteve anëtare në çështjet civile dhe ekonomike (Brukseli II).

- Të njohin përmbajtjen e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian, Nr. 593/2008 e 17 qershorit 2008 mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuese (Roma I),
- Të njohin përmbajtjen e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC), Nr. 864/2007 e 11 korrikut 2007 mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jo-kontraktuese (Roma II).
- Të marrin vendime duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg.

Përfitues të këtij trajnimi ishin trajnuesit e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Trajnim për Trajnues: “Tryezë Pune për Zhvillimin e Shkathtësive të Avancuara të Trajnuesve”



Më 28 dhe 29 prill, 2011 IGJK organizoi një tryezë pune dy ditore për trajnuesit e angazhuar në Programin Fillestar për Arsimimin Ligjor.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive prezantuese në mënyrë sa më efektive duke përdorur një larmi metodash të mësimdhënies, me ç'rast u kërkua nga trajnuesit **demonstrimi** i teknikave të mësimdhënies dhe u morën komente nga trajnuesi dhe kolegët.

Rëndësia e kësaj tryeze konsiston në atë se pjesëmarrësit pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje të:

- zhvillojnë shkathtësitë e një prezantimi shumë efektiv;
- hartojnë objektiva të qarta mësimore duke përfshirë ushtrimet praktike për trajnim;
- zhvillojnë një sesion trajnimi duke përdorur objektivat mësimore për të organizuar përmbajtjen e trajnimit;
- aplikojnë metodat interaktive të mësimdhënies në trajnim;
- menaxhojnë kohën e trajnimit sipas agjendës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin trajnuesit gjyqësor dhe stafi i Institutit Gjyqësor të Kosovës i cili merret me zhvillimin e programeve për arsimim ligjor.

2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)

Moduli: E drejta kushtetuese



Më 20 prill 2011, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim realizoj sesionin e radhës me temë “E Drejta Kushtetuese”.

Disa nga objektivat kryesore të këtij trajnimi ishin që pjesëmarrësit pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje që të:

- Njohin burimet kushtetuese në Kosovë;
- Kuptojnë strukturën e Kushtetutës së Kosovës dhe vlerat të cilat i bartë ajo;
- Dallojnë rastet kur e drejta ndërkombëtare mbizotëron në raport me Kushtetutën e Kosovës;

- Njohin bazën juridike lidhur me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese; dhe Dallojnë subjektet të cilët e vejnë në lëvizje një proces të kontrollit kushtetues.

Çështjet të cilat janë u trajtuan gjatë këtij trajnimi kryesisht kishin të bënin me burimet kushtetuese në Kosovë, natyrën dhe efektin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ankesat individuale, kushtet materiale dhe procedurale për paraqitjen e ankesës, afatet kohore dhe procedurën për shqyrtimin e ankesës, si dhe çështje tjera lidhur me fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, në fokus të trajtimit ishin elementet që e bëjnë natyrën juridike të Kushtetutës të veçantë, si: procesi shtet formues i Kosovës, dispozitat kontradiktore të vet Kushtetutës në lidhje epërsinë dhe Planin e Presidentit Ahtisari, mungesa e preambulës në Kushtetutë, arsyet për mos paraqitjen e saj dhe në fund edhe rrethanat kur mund të ndryshohen dispozitat të cilat prekin edhe Planin e Presidentit Ahtisari.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët nga Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje nga gjitha regjionet e Kosovës.

3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)

Administrimi dhe vlerësimi i Provimit Përgatitor

Provimi Përgatitor për gjeneratën e katërt të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor është mbajtur gjatë muajit prill. Pjesa me shkrim e këtij provimi është mbajtur me datën 02 prill në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) në Vushtrri. Provimi ka qenë i ndarë në pesë (5) pjesë dhe i janë nënshtruar 161 kandidatë.

Ky provim është administruar nën masa të rrepta sigurie të cilat kanë garantuar një proces konfidencial, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët. Provimi është mbajtur nën monitorimin e monitoruesve ndërkombëtarë si dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Vlerësimi i provimit është bërë nga Komisioni për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit me 04 dhe 05 prill në ambientet e IGJK-së, në hapësira me qasje të kufizuar nga stafi Provimi. Vlerësimi u bë në mënyrë anonime, duke vlerësuar vetëm numrat sekret të provimit.

Më 12 prill, publikisht, në prani të kandidatëve, përfaqësuesve të OSBE-së dhe një përfaqësuesi të Këshillit Drejtues të IGJK-së, u hapën zarfet me emra të kandidatëve me ç'rast u bë përshtatja e numrit të provimit me emrin e kandidatit. Bazuar në rregullat e provimit të aprovuara nga Këshilli Programor i IGJK-së, 70 rezultatet më të larta u kualifikuan që të marrin pjesë në provimin me gojë.

Nga numri i përgjithshëm i kandidatëve që iu nënshtruan provimit me shkrim 92 prej tyre u përfshinë në grupin e 70 rezultateve më të larta (këtu janë përfshirë rezultatet e njëjta). Këta kandidat u ftuan të marrin pjesë në provimin me gojë i cili u mbajt me 16 prill.

Rezultatet përfundimtare treguan se 42 e kaluan Provimin Përgatitor dhe janë duke ndjekur trajnimet në Programin Fillestar për Arsimin Ligjor (PFAL) të organizuar nga IGJK-ja.

Kandidatët të cilët nuk kanë kaluar provimin kanë pasur mundësi të parashtrojnë ankesë apo kërkesë që të shohin provimet e tyre me qëllim të verifikimit të pikëve të fituara.

Trajnimet e PFAL III

Gjatë muajit prill kanë vazhduar trajnimet për fazën e dytë dhe të tretë të gjeneratës së tretë të kandidatëve në Programi Fillestar për Arsimim Ligjor.

Këto trajnime kandidatët i kanë ndjekur varësisht nga profili që iu është caktuar, ku kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnime në module të ndryshme nga ata për prokurorë. Secili grup ka pasur nga 12 module trajnuese.

Trajnimet në fazën e dytë do të vazhdojnë deri në fund të muajit maj, ku në fund të trajnimeve të kësaj faze kandidatët do t'i nënshtrohen provimeve

për secilin modul trajnues që kanë ndjekur trajnime. Kësaj faze kandidatët do t'i nënshtrohen provimeve për secilin modul trajnues që kanë ndjekur trajnime.

Ndërsa trajnimet në fazën e tretë kandidatët i kanë vijuar në gjykata apo prokurori varësisht ku janë vendosur sipas profilit të tyre.

Trajnimet praktike janë mbajtur nën mbikëqyrjen e Mentorit gjyqtarë apo prokurorë, sipas programit të përcaktuar nga IGJK në koordinim me Koordinatorët e Mentorëve.

Këto trajnime janë ndjekur nga 32 kandidatë.

Aktivitetet tjera

Konferencë ndërkombëtare – Zagreb të Kroacisë

Temë: Gjyqtari/Prokurori Vendor dhe Evropian - Roli i Qendrave për Trajnim Profesional”.

Më 7 dhe 8 prill 2011 në Zagreb të Republikës së Kroacisë është zhvilluar konferenca ndërkombëtare me temë Gjyqtari/Prokurori Vendor dhe Evropian - Roli i Qendrave për Trajnim Profesional”.

Në sesionin e parë të kësaj konference u nënshkrua Marrëveshja për Bashkëpunim Multilateral në aspektin regional në fushën e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këtë marrveshje e nënshkruan përfaqësues të institucioneve të trajnimit nga:

Polonia, Hungaria, Sllovenia, Bosna e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Kroacia dhe Sllovakia. Këtë marrveshje për Institutin Gjyqësor të Kosovës e nënshkroi Drejtori i Institutit i z.Lavdim Krasniqi cili mori pjesë në këtë

konferencë. Programi i konferencës kishte për diskutim temat, si: Mësimi për të Drejtën e BE-së, Mësimi në Distançë (e-learning) dhe Trajnimi i Trajnuesve për të drejtën e BE-së. Gjatë konferencës u shkëmbyen përvoja të ndryshme në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme dhe trajnimit fillestar si dhe u diskutua për praktikat e aplikimit për fonde të BE-së dhe aspektet e punës me programet e binjakëzimit.

Pjesmarrës në këtë konference ishin përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë nga: Sllovenia, Polonia, Hungaria, Bosna e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Kroacia, Sllovakia, Spanja, Franca dhe Bullgaria.

Trajnim Stafi “ Hartimi dhe zhvillimi i Kurrikulumit”

Tema: Zhvillimi i Kurrikulave të trajnimit

Më 28 dhe 29 prill 2011, IGJK në bashkëpunim me GIZ – “Projekti për Reformën Ligjore në Kosovë” ka realizuar një punëtori dy ditore ku është diskutuar lidhur me zhvillimin e kurrikulave trajnuese të IGJK-së.

Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte mbështetja e stafit dhe trajnuesve të IGJK-së lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve trajnuese duke filluar nga identifikimi i objektivave, përmbajtjes dhe metodave të mësimi si dhe vlerësimi i nevojave, me qëllim që ata të thellojnë njohuritë lidhur me standardet më të larta zhvillimin e kurrikulumit dhe që ato standarde të inkorporohen në kuadër të programeve të IGJK-së.

Çështjet të cilat janë trajtuar gjatë kësaj punëtorie kryesisht kishin të bënin me; kompetencat,

leadershipin dhe vetë-menaxhimin me përgjegjësi etike, planifikimin konceptual dhe reformimin organizativ duke u trajtuar modelet specifike për përkufizimin e objektivave mësimore dhe transformimi i këtyre objektivave në procedura operative.

Gjatë kësaj tryeze pjesëmarrësit të ndarë në grupe identifikuan përparësitë dhe mangësitë e aktiviteteve trajnuese në kuadër të programeve të IGJK-së dhe në bashkëpunim me ekspertët diskutuan për mundësitë e evitimit të mangësive.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin stafi profesional dhe trajnerët e IGJK-së, ndërsa ekspertët ishin ofruar nga KIZ në kuadër të projektit “Strategjia për Mbështetjen e IGJK-së”.